



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 1678 prot.

Vlorë, më 18.10 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL LOKAL PËR VITET 2025-2027

Në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 54 pika k dhe n, Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshur, Ligjit nr. 121 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e kujdesit Shoqëror", Ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjit nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (FZ 20-1996), Udhëzim nr. 556, datë 29.7.2019 "Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje", Udhëzim nr. 394, datë 9.5.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijët në familjet kujdestare", VKM nr. 150, datë 20.3.2019, "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, Vendim nr. 624, datë 29.7.2020 "Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror", Vendim nr. 848, datë 28.10.2020 "Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre", Udhëzim nr. 584, datë 31.7.2019, "Për rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, Udhëzimi nr. 354/2022 "Për miratimin e standardeve për shërbimin e strehimit emergjent të sigurt", Udhëzim nr. 458, datë 26.07.2022 "Për procedurën e hedhjes së të dhënave dhe dokumentacionit në Arkivën e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar", Udhëzimi nr. 169, datë

29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijë 0-5 vjeç dhe manuali i zbatimit të tij”.

Planj i transformimit të Institucioneve të IPSH 0-5 vjeç, Bashkia Vlorë dhe Korçë janë bashki ku po implementohet për herë të parë transformimi i shërbimeve miratuar nga Komiteti Drejtues për De-institucionalizimin.

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Social Lokal, për vitet 2025-2027 Bashkia Vlorë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b.

K R Y E T A R

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 1678 prot.

Vlorë, më 18.10 2024

RELACION

mbi

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL LOKAL , 2025-2027”

Mbështetur ne ligjin 139/" Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimet e kujdesit Shoqëror”, Ligjin nr. 47/2018" Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Ligjin 15/2019 “Per nxitjen e punësimit”, Ligjin 57/2019 “Për asistencë sociale ne RSH”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligji nr. 1021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor në teresi, Bashkia Vlorë ka hartuar planin e ri social 2025-2027.

Përgatitja e Planit Social të Bashkisë Vlorë u mundësua me fondet e të BE-së në kuadër të projektit “Fuqizim i kapaciteteve dhe angazhimit në politika të ofruesve të shërbimeve –IRIS PROGRES”, zbatuar nga qendra “Psiko-Sociale Vatra”. Aneks 1, hartimi i Planit Lokal Social për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë nga shoqata “Ndhmoni Jetën”. Ky Plan Social Lokal është mbështetur nga reforma e kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të mbështetjes së Qeverisë Shqiptare për të mundësuar përfshirjen e gjithë target-grupeve në nevojë.

Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht:

(1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e

dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

(2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

(3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

(4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financim e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Reforma e transformimit të shërbimeve rezidenciale dhe promovimin e shërbimit me bazë komunitare në kuader të procesit të De-institucionalizimit.

Financimi i shërbimeve është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 "Per shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe në pikën 2 të VKM nr. 111 datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social", sipas të cilit çdo Bashki nëpërmjet Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) fondet nga buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; (c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individet dhe bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; (ç) tarifatat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Jo vetëm ligji por edhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave i sipërcituar kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qëndrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë në kuadrin e hartimit dhe miratimit të Planit Social të saj.

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Vlorë ka nxjerrë prioritetet për vitet 2025-2027 i cili ka si detyrim garantimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë dhe standarte të shërbimeve sociale në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar cilësinë e jetës së fëmijeve dhe të riturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, si të moshuarit e vetmuar dhe personat me AK duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Bashkëlidhur gjeni dhe Planin Social Lokal 2025-2027 të detajuar.

Konceptoi: *K. Billa*




Drejtor i Ndhmës dhe Shërbimit Social

Irena Stasa



PLANI SOCIAL LOKAL 2025 – 2027 BASHKIA VLORE

KONSULTIM PUBLIK
TAKIM, 14 TETOR 2024



HYRJE

Plani Social Lokal i Bashkisë Vlorë për periudhën 2025-2027 është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” .

Ky plan synon të adresojë nevojat sociale të komunitetit, veçanërisht të kategorive vulnerabël.

Dokumenti përmban një analizë të plotë të situatës aktuale dhe parashikon veprime konkrete për përmirësimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.

OBJEKTIVAT E PLANIT LOKAL SOCIAL

Ndërtimin e një sistemi të integruar dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale, që përputhet me nevojat e komunitetit.

Forcimin e kapaciteteve të institucioneve lokale, për të ofruar shërbime të kujdest shogëror në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zhvillimin e partneriteteve midis institucioneve publike dhe organizatave joqeveritare për ofrimin e shërbimeve sociale.

Rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për kategoritë vulnerabël si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, gratë, të moshuarit, dhe familjet në nevojë.

METODOLOGJIA PËR PËRGATITJEN E PLANIT

Procesi metodologjik për përgatitjen e Planit Social Lokal ka përfshirë:

- Konsultimi me legjislacionin dhe strategjitë kombëtare**, duke përfshirë Kushtetutën e Shqipërisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, etj.
- Intervistat gjysmë të strukturuar** me stafin e bashkisë dhe ofruesit e shërbimeve lokale për të vlerësuar kapacitetet ekzistuese dhe nevojat e komunitetit.
- Mbledhja e të dhënave demografike dhe statistikore** për identifikimin e kategorive vulnerabel dhe shërbimeve ekzistuese.
- Tryezat e rrumbullakëta me aktorët lokalë dhe me përfitues të shërbimeve sociale**, për verifikimin dhe diskutimin e informacionit dhe për identifikimin e zgjidhjeve të reja për ngriçjen e një sistemi të integruar të shërbimeve sociale.

ANALIZA E STRUKTURAVE AKTUALE TË SHËRBIMEVE SOCIALE NË BASHKINË VLORE

Organizimi i Strukturave Lokale për Shërbimet Sociale - **Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social** është përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve sociale në Bashkinë Vlorë. Drejtoria përbëhet nga disa njësi, të cilat përfshijnë:

- **Njësia e Ndhmës Ekonomike:** Menaxhon programet e ndihmës ekonomike dhe shpërndarjen e mbështetjes financiare për personat që plotësojnë kriteret. Përfshin role si Specialisti i Financës dhe Specialisti i P.A.K (aftësitë e kufizuara).
- **Njësia e Shërbimit Social:** Përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, përfshin role si Koordinatori Vendor për Dhunën në Familje, Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve, dhe specialistë për vlerësimin e nevojave dhe referimin.
- **Njësia për Barazinë Gjinore:** Përfshin specialistë që trajtojnë çështje të diskriminimit gjinor dhe promovojnë barazinë gjinore në politikën dhe shërbimet sociale.

SFIDAT DHE NEVOJAT E STRUKTURAVE SOCIALE NË BASHKINË VLORE

Sfidat kryesore të identifikuara në strukturat aktuale për shërbimet sociale:

- **Mungesa e fondeve për menaxhimin e rasteve sociale**, duke përfshirë nevojat bazë si ushqimi dhe mbështetja ekonomike.
- **Mungesa e mjeteve logjistike** për mbulimin e territorit të gjerë të bashkisë, veçanërisht për njësitë administrative si Novosela dhe Shushica.
- **Mungesa e shërbimeve referuese në nivel lokal** për rastet që kanë nevojë për mbështetje të specializuar.
- **Nevoja për trajnime të vazhdueshme për stafin**, veçanërisht në menaxhimin e rasteve, qasjen e integruar dhe monitorimin e shërbimeve.

Përmirësimet e nevojshme: Zgjerimi i kapaciteteve logjistike dhe njerezore. Trajnime të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve sociale. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse.

ANALIZA E NEVOJAVE PËR SHËRBIME SOCIALE NË BASHKINË VLORË

Kategoritë kryesore të grupeve në nevojë dhe sfidat/nejorat

- **Personat me aftësi të kufizuara (PAK):** 2408 persona me aftësi të kufizuara, përfshirë 207 fëmijë me aftësi të kufizuara. Shërbimet ekzistuese për këtë kategori përfshijnë: mbështetje financiare dhe shërbime shoqërore, por ka nevojë për përmirësime në shërbimet e specializuara dhe aksesueshmëri.
- **Familjet përfituese të ndihmës ekonomike:** 618 familje përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, me rënie nga viti 2022. Nevojiten programe të qëndrueshme për fuqizimin ekonomik dhe mbështetje psiko-sociale për këto familje.
- **Punëkërkuesit:** 2754 individë të papunë, ku shumica janë gra dhe persona mbi 40 vjeç. Mungesa e kualifikimeve dhe aftësi specifike është një nga faktorët kryesorë të papunësisë.
- **Fëmijët në nevojë për mbrojtje:** 490 fëmijë që kërkojnë mbrojtje dhe përkujdesje të veçantë. Reduktimi i numrit të fëmijëve në institucionet rezidenciale tregon një fokus më të madh tek kujdesi familjar.

ANALIZA E NEVOJAVE PËR SHËRBIME SOCIALE NË BASHKINË VLORE

- **Viktimat e dhunës në familje.** 275 viktima u pajisën me urdhër mbrojtjeje në 2023, nga të cilët:135 me UMM (Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje)140 me UM (Urdhër Mbrojtjeje); Prej tyre:126 gra,10 fëmijë, 9 burra; - shërbimet për viktimat e dhunës në familje përfshijnë një gamë të gjerë mbështetjesh, duke filluar nga urdhrat e mbrojtjes dhe ndihma e menjëhershme deri te shërbimet rehabilituese dhe riintegruese. Mekanizmi i referimit me pjesëmarrjen e institucioneve të ndryshme lokale është ngritur, por është e nevojshme sigurimi i mirëfunksionimit të këtij mekanizmi.
- **Të moshuarit në nevojë për përkujdesje.** Numri i të moshuarve në nevojë për përkujdesje:100 të moshuar vetmuar72 të moshuar të sëmurë26 të moshuar të braktisur78 të moshuar të varfër;45 të moshuar me aftësi të kufizuara. Shërbimet për të moshuarit janë të kufizuara në Bashkinë Vlorë, veçanërisht në njësitë administrative dhe zonat rurale.
- **Familjet e pastreha:** nga viti 2021 – 2024 kanë aplikuar për të përfiturar nga programet e strehimit që aplikon Bashkia Vlorë 380 familje. Në vitin 2023 numri i aplikimeve ishte 140.

ANALIZË E SHËRBIMEVE SOCIALE EKZISTUESE NË BASHKINË VLORE

- **Shërbime të kufizuara:** Në territorin e Bashkisë së Vlorës ekzistojnë disa shërbime sociale, por ato janë të kufizuara dhe nuk përfshijnë një gamë të gjerë të nevojave sociale.
- Buxhet i kufizuar për shërbimet shoqërore: Ndërkohë që Bashkia ka alokuar disa fonde për shërbimet e kujdesit shoqëror, këto fonde kanë qenë të kufizuara dhe jo të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e plotë të shërbimeve sociale.
- **Roli dominues i OJQ-ve:** Shërbimet ekzistuese në Vlorë janë kryesisht të ngritura dhe të menaxhuara nga organizata jofitimprurëse, me bashkëpunimin e Bashkisë për rastet specifike. Kjo varësi nga OJQ-të nënkupton që shërbimet mund të jenë të kufizuara nga burimet dhe prioritetet e këtyre organizatave dhe jo domosdoshmërisht nga nevojat specifike të komunitetit.
- **Qëndrueshmëria e projekteve të mbështetura nga donatorët:** Edhe pse sektori i shërbimeve sociale ka arritur të ndërtojë partneritete të suksesshme me organizata jofitimprurëse dhe donatorë, mbështetja e tyre shpesh është e përkohshme dhe e lidhur me projekte specifike. Kjo krijon sfida në vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve pas përfundimit të financimeve të jashtme.

ANALIZË E SHËRBIMEVE SOCIALE EKZISTUESE NË BASHKINË VLORE

1. Shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë: Pavarësisht përmirësimeve, ka mungesa në ndërhyrjet e hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shërbime për fëmijët në nevojë për mbrojtje. është e nevojshme zgjerimi i shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror bazuar në modelet e shërbimeve të dakordësuara në kuadër të reforme=ës së de – institucionalizimit..

2. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara: Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara janë të kufizuara, sidomos në zonat rurale, dhe nevojiten përmirësime në aksesueshmërinë e shërbimeve.

3. Shërbimet për gratë dhe vajzat: Disa programe të ndihmës ekonomike dhe për mbrojtjen nga dhuna janë në zbatim, por nevojiten më shumë mundësi për fuqizimin ekonomik të grave.

4. Shërbimet për të moshuarit: Për të moshuarit ofrohen disa shërbime mbështetëse, por është e nevojshme zgjerimi i shërbimit ditor dhe rritja e investimeve në kujdesin afatgjatë.

VIZIONI

Bashkia Vlorë synon të ndërtojë një sistem gjithëpërfshirës dhe të balancuar shërbimesh sociale, që ofron mbrojtje, përkujdesje, rintegrim, fuqizim dhe përfshirje sociale për individët në nevojë, duke respektuar standardet kombëtare dhe kornizën ligjore. Këto shërbime do të jenë të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë, të shumëllojshme dhe të bazuara në nevojat reale të popullsisë. Përmes një qasjeje me personin në qendër dhe bashkëpunimit ndërsektorial, Bashkia Vlorë do të sigurojë burime të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të standardizuara dhe zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe të reja.

**PJESA E DYTË:
PLANI SOCIAL
LOKAL**

OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Objektivi strategjik 1:

Ngritja, fuqizimi dhe funksionimi efektiv i strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Vlorës, për të siguruar ofrimin cilësor dhe të koordinuar të shërbimeve për të gjithë qytetarët në nevojë.

Objektivi strategjik 2:

Ngritja dhe përmirësimi i rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar, duke përfshirë zgjerimin dhe funksionimin efektiv të shërbimeve ekzistuese, si dhe krijimin e shërbimeve të reja, për të siguruar mbulimin e plotë dhe të qëndrueshëm të nevojave sociale të komunitetit.

MASAT E PARASHIKUARA PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN STRATEGJIK I

Objektivi strategjik 1:

Ngritja, fuqizimi dhe funksionimi efektiv i strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Vlorës, për të siguruar ofrimin cilësor dhe të koordinuar të shërbimeve për të gjithë qytetarët në nevojë.

- Rritja e numrit të stafëve sociale në nivel bashkie dhe njësis administrative do të jetë në focus të përmirësimit të punës në fushën e shërbimeve sociale.
- Ngritja e strukturave të shërbimeve sociale në nivel njësis administrative.
- Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të personelit:
- Zhvillimi i gjasës ndërsektoriale për identifikimin dhe referimin e rasteve:
- Monitorimi i shërbimeve sociale të ofruara në territorin e bashkisë Vlorë.
- Monitorimi dhe rishikimi periodik i Planit Social Lokal:

Objektivi strategjik 2:

Ngritja dhe përmirësimi i rrejtë të shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar, duke përfshirë zgjerimin dhe funksionimin efektiv të shërbimeve ekzistuese, si dhe krijimin e shërbimeve të reja, për të siguruar mbulimin e plotë dhe të qëndrueshëm të nevojave sociale të komunitetit.

**MASAT E PARASHIKUARA PËR
TË PËRMBUSSHUR OBJEKTIVIN
STRATEGJIK 2**

Ngritja e shërbimeve sociale të reja,
dhe

Vijimi i mbështetjes/ofrimit, zgjerimi
dhe përmirësimi i shërbimeve
ekzistuese.

AKTIVITETET SPECIFIKETË PARASHIKUARA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 1&2

Objektivi Specifik 1

Shtimi i burimeve njerëzore me një specialist të ri në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, për të mbështetur hartimin e politikave sociale lokale dhe monitorimin e shërbimeve shoqërore.

Shtimi i burimeve njerëzore në nivelin e njësisë administrative me 3 stafe të reja – NJVRN, NJMF, KVDHF.

Ngritja e strukturave të shërbimeve sociale në nivel njësisht administrative. – NJVRN & NJMF.

Trainime të stafëve të Sektorit Social, NJVRN dhe NJMF.

Sigurimi i mirefunksionimit të Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.

Objektivi Specifik 2

Ngritja dhe vënia në funksionim të Qendrës e Shërbimeve Multifunksionale Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen – 5 modele të shërbimit

Ngritja dhe funksionimi i qendrës multifunksionale për persona me aftësi të kufizuara për grup moshën 21+ vjeç.

Ngritja dhe funksionimi i një qendre ditore të dytë për të moshuarit.

Vijimi i mbështetjes dhe funksionimi i qendrës egzistuese ditore për të moshuarit

Vijimi i mbështetjes dhe funksionimi i qendrës ditore me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara.

MASAT SPECIFIKE TË PARASHIKUARA

Objektivi Specifik 1	Objektivi Specifik 2
Mirëfunksionimi i Komitetit Drejtues Lokal në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës.	Vijimi i mbeshtetjes së Qendres për gra dhe vajza viktima të dhunës me bazë gjimore/viktima të trafikimit. Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve mbështetëse edhe në njësitë administrative
Mirëfunksionimi i Grupeve Ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve sociale.	Vijimi i mbeshtetjes me kuotave në kopshte dhe çerdhe për fëmijët e familjeve më në nevojë për të marrë shërbimin pa pagesë.
Takime komunikare me qëllim informimin e komuniteteve lokale mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe si ti aksesojnë ato;	Vijimi i mbeshtetjes me skemën e ndihmës ekonomike të familjeve në nevojë.
Monitorimi i shërbimeve sociale të ofruara në territorin e bashkisë Vlorë	Vijimi i mbeshtetjes me skemën e pagesës së personave me aftësi të kufizuar bazuar në vlerësimet biopsiko - sociale.
Monitorimi dhe rishikimi periodik i Planit Social Lokal	Vijimi i mbeshtetjes me skemën e pagesës së viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit sipas përcaktimeve në ligji



ANËKKS PLANI LOKAL SOCIAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2025 - 2027, BASHKËIA VLORE



Analiza e situatës

Në Bashkinë Vlorë rezultojnë gjithsej 2,408 persona me aftësi të kufizuara. Nga ky numër 207 janë fëmijë me aftësi të kufizuara.

Njësia administrative	Vlorë	Qendër	Orikum	Novoselë	Shushicë	TOTALI BASHKIA
Nr.i PAK	1761	195	132	199	121	2408

Në Bashkinë Vlorë marrin shërbime të specializuara rreth 100 fëmijë me AK në 2 Qendrat e shërbimeve: Qendra e Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe Qendra e Zhvillimit Rezidencial për PAK. Bashkia ka pas gjithmonë në vëmendje ofrimin e një game shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara në këto qendra.

Nga taktimet me grupet e interesit u evidentuan këto nevoja për ndërhyrje:

- Ofrimi i shërbimeve për të rriturit me AK mbi 21 vjeç.
- Përmirësimi i infrastrukturës, duke përfshirë mjediset, transportin, institucionet dhe aksesin në informacion
- Ofrimi i shërbimit të ndërhyrjes së hershme për grupmoshën 0-6 vjeç.
- Zhvillimi i shërbimeve levizëse në banesë për personat me aftësi të kufizuara.
- Hartëzimi i gjithë shërbimeve për personat me AK në Bashkinë Vlorë.
- Shtimi i stafit psiko-social për fëmijët me AK në institucionet e edukimit të hershëm (çerdhe, kopshte).

Plani lokal i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

1. Qëllimi: Përmirësimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Vlorë deri në fund të vitit 2027.

Objektivi specifik 1: Përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së aksesueshmërisë në mjedise, transport, informacion dhe komunikim, deri në dhjetor 2027, në Bashkinë Vlorë.

Aktiviteti 1

Reduktimi i barrierave ekzistuese në mjedise.

Përmirësimi i aksesueshmërisë në mjedise publike për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që lejet e reja dhe ekzistuese të respektojnë standardet e përshatshmërisë

Aktiviteti 2

Reduktimi i barrierave ekzistuese në transport.

Përmirësimi i aksesueshmërisë në sistemin e transportit për personat me aftësi të kufizuara, me fokus në kontratat e reja për shërbimet e transportit publik.

Aktiviteti 3

Reduktimi i barrierave në informacion dhe komunikim.

Grupi pune me 3 specialistë të fushës ose ekspertë, secili 10 ditë me qëllim përshatjen e të gjithë informacionit ekzistues për PAK. Krijimi dhe shpërndarja e informacionit, 10 fletë informative, dhe afro 50 tabela simbolesh.

Aktiviteti 4

Krijimi i regjistrit të aksesueshmërisë në mjedise, transport, informacion dhe komunikim.

Percaktimi i një specialisti në drejtorinë e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale, drejtorinë e urbanistikës dhe drejtorinë e burimeve njerëzore të cilët do të ndjekin zbatueshmërinë e kërkesave për elementët e përshatshmërisë.

Aktiviteti 5

Zbatimi i plotë i standardeve të përshatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në të paktën katër institucione publike

Aktiviteti 6

Rritja e ndërgjegjesimit të komunitetit dhe trajnimi i personelit të bashkisë për zbatimin e standardeve të përshatshmërisë.

Plani lokal i veprimt për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

2. Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet mbulimit me shërbime të diversifikuara dhe rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Objektivi specifik 1: Zgjerimi i gamës dhe shtrirjes gjeografike së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara deri në dhjetor 2027.

Aktiviteti 1

Zhvillimi, zgjerimi dhe larmishmëria i shërbimeve në Qendren e Shërbimeve Komunitare për Femijet me Aftësi të Kufizuara.

1. Duke rekrutuar specialistë si logopedë, terapistë zhvillimi, punonjës socialë dhe specialistë të tjerë me kontratë të përkohshme, bazuar në nevojat specifike të fëmijëve

Aktiviteti 2

Ofrimi i shërbimit në familje/banësë (asistencë shtëpiake).

1. Krijimi i një ekipi levizës multidisciplinor për të ofruar shërbim asistencë shtëpiake
2. Hartimi i procedurave standarde të veprimt dhe formateve të punës të ekipit, bazuar në standartet e shërbimit.
3. Trajtimi i ekipit për të siguruar cilësinë e shërbimit.

Aktiviteti 3

Shërbimi i ndërhyrës së hershme.

1. Rritja e njohurive dhe kapaciteteve profesionale të stafit mjekësor, dhe atij në cerdhe dhe në kopshte.
2. Rritja e kapaciteteve të stafit piko-social pranë shërbimeve sociale, shëndetësore
3. Hartimi i procedurave standarde të shërbimit dhe formateve të punës.
4. Rekrutimi i punonjësve social dhe asistologëve në cerdhe dhe kopshte.

Aktiviteti 4

Krijimi i një klime dhe mjedisi të përshatshëm për ofrimin e shërbimit të jetesës së pavaruar.

1. Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme me të rinj me Ak mbi "aftësimin për jetën" dhe jetesën e pavarur.
2. Trajtimi i stafit të shërbimeve sociale në bashki mbi standartet e shërbimit të jetesës së pavarur.
3. Informimi dhe edukimi i familjarëve dhe komunitetit mbi jetesën e pavarur për PAK

Aktiviteti 5

Krijimi i një ekipi profesionistësh për të ofruar shërbimeve të integruara komunitare për personat e rritur me aftësi të kufizuara, pranë qendrës rezidenciale për PAK, Vlorë.

1. Trajtimi i ekipit multidisciplinor.
2. Zhvillimi i paketës së punës dhe procedurave standarde të veprimt të ekipit.

Aktiviteti 6

Përmirësimi i shërbimeve të strehimit

1. Informimi, këshillimi dhe mbështetja e PAK mbi kriteret e përfundimit të strehimit sipas standardeve të përshatshmërisë.
2. Zhvillimi i takimeve informuese për PAK mbi gëshfjet e strehimit.
3. Përgatitja e materialeve informuese në lidhje me kriteret e përfundimit të strehimit sipas standardeve të përshatshmërisë

Aktiviteti 6

Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve për punësimin

1. Informimi dhe edukimi i punëdhënësve potencialë në lidhje me zbatimin e kuartrt ligjor për punësimin e PAK.
2. Bashkëpunimi me zyrën e punës për promovimin e punësimin të PAK

Plani lokal i veprimt për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

2. Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet mbulimit me shërbime të diversifikuara dhe rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Objektivi specifik 2: Brenda qershorit 2026 stafet e strukturave të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara do të kenë rritur kapacitetet e profesionale për të përbushur cilësisht detyrat funksionale

Aktiviteti 1

Trajnimi periodik i stafit të drejtorisë së ndihmës dhe shërbimeve sociale, administratorëve shoqëror, stafit të qendrës së shërbimeve komunitare dhe profesionistëve të tjerë për të drejtat e PAK, kuadrin ligjor, gëshfje etike, dhe përdorimin e bazës së të dhënave nga vlerësimi bio-psiko-social.

1. Zhvillimi i të paktën një cikli trajnimi tre-ditor në vit, me pjesëmarrjen e 10-15 profesionistëve,

Aktiviteti 2

Përmirësimi i bazës së të dhënave për personat me aftësi të kufizuara nga specialisti përkatës në drejtorinë e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

Aktiviteti 3

Supervizimi periodik i ekipeve që punojnë me PAK, i organizuar nga drejtuesit e ekipeve, ekspertë të pavarur, organizata të shërbimeve sociale dhe Fakulteti i Shkencave Humane.

1. Organizimi i të paktën një seance formale supervizimi çdo muaj dhe tre seanca nga ekspertë të jashtëm.
2. Nënshkrimi i marrëveshjes me Fakultetin e Shkencave Humane.

Aktiviteti 4

Mbështetja dhe sigurimi me materiale burimore dhe përdikësim periodik të tyre.

1. Trajnim dy ditor i të gjithë stafit që punon direkt dhe indirekt me PAK mbi identifikimin dhe prezantimin e burimeve dhe platformave online për çështjet e mbrojtjes e kujdestari social dhe AK.

Aktiviteti 5

Krijimi i një faqe apo platforme online me informacion të detajuar mbi aftësinë e kufizuar dhe shërbimet përkatëse në Bashkinë Vlorë që të aksesohet nga personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.

Plani lokal i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

3. Sigurimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në aktivitete publike, sportive dhe social-kulturore, duke rritur aksesin e tyre në mjediset sportive dhe kulturore dhe duke promovuar pjesëmarrjen aktive në jetën publike.

Objektivi specifik 1: Rritja e aksesit në mjediset sportive dhe kulturore dhe angazhimi i personave me aftësi të kufizuara në aktivitete të ndryshme sportive dhe social-kulturore deri në dhjetor 2027.

Aktiviteti 1

Garantimi i tarifave të reduktuara dhe hyrjes falas në Institucionet Sportive dhe Kulturore

1. Sigurimi i aplikimit të tarifave të reduktuara dhe hyrjes falas në institucionet sportive, kulturore dhe artistike për personat me aftësi të kufizuara.

2. Hartimi dhe njoftimi i një liste të përditësuar të institucioneve që ofrojnë këto lehtësira.

Aktiviteti 2

Organizimi i Aktiviteteve Kulturore dhe Sportive për Personat me Aftësi të Kufizuara.

1. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive periodike për PAK, duke përfshirë aktivitete njëditorë me rreth 20 pjesëmarrës në mjediset e qendrës komunitare dhe natyrë.

2. Mxitja e përfshirjes së PAK në aktivitete publike, sportive, kulturore dhe artistike, si dhe promovimi i këtyre aktiviteteve.

Aktiviteti 3

Informimi i personave me aftësi të kufizuara mbi aktivitetet publike, sportive dhe kulturore.

1. Informimi i PAK në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për të gjitha aktivitetet publike, sportive, kulturore dhe artistike që organizohen në Bashki.

2. Klubit dhe institucionet përkatëse njoftojnë Drejtorinë e Ndalimit Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, njësitë administrative dhe qendrën komunitare për PAK për kalendarin e aktiviteteve.

Aktiviteti 4

Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në Proceset e Vendimmarrjes Publike.

1. Sigurimi i informimit dhe përfshirjes së PAK si grup interesimi me të drejta të plota në dëgjesat publike për hartimin e reformave dhe politikave sociale, shëndetësore, orsimore dhe të punës.

2. Informimi i tyre në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme për proceset e hartimit të dokumenteve politike dhe takimet e kështjëlloj Bashkia.

Plani lokal i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

4. Sigurimi i një bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për të garantuar të drejtat dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar koordinimin dhe efikasitetin e përgjigjes institucionale.

Objekti i specifik 1: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të sektorit publik dhe jopublik që lidhen direkt dhe indirekt me fushën e aftësisë së kufizuara deri në dhjetor 2027.

Aktiviteti 1

Vendosja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet relevante.

1. Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet që posedojnë të dhëna për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e PAK.
2. Përgatitja e formatit të marrëveshjeve të bashkëpunimit nga një grup pune me të paktën dy anëtarë (specialist i aftësisë së kufizuara dhe zyra juridike e bashkisë).
3. Organizimi i tre takimeve periodike (një në vit) për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve.

Aktiviteti 2

Hartimi i një rregulloreje/udhëzuesi për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve për formën e bashkëpunimit, afatet kohore dhe modalitetet të tjera të nevojshme.

1. Zhvillimi i tyrezeve të rumbullakëta për të diskutuar dhe diskutuar me institucionet për formatet e të dhënave për aftësinë e kufizuara dhe modalitetet e bashkëpunimit.

Aktiviteti 3

Analiza periodike ndërsëktoriale për çështjet e aftësisë së kufizuara

1. Organizimi i takimeve të përvishme ndërsëktoriale për të diskutuar dhe analizuar çështjet e aftësisë së kufizuara me përfaqësuesit e institucioneve partnere.
2. Zhvillimi i analizave vjetore të të dhënave dhe veprimtarive për personat me aftësi të kufizuara.

Plani lokal i veprimt për personat me aftësi të kufizuara 2025-2027

5. Sigurimi i zbatimit efektiv dhe monitorimit të vazhdueshëm të Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuara (PLSPAK) për të garantuar përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të tij.

Objektivi specifik 1: PLSPAK do të promovohet dhe zbatohet me efikasitet dhe efektivitet deri në dhjetor 2027, duke mbuluar të gjitha qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e planifikuara..

Aktiviteti 1

Përshtatja e PLSPAK për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuara

1. Përshtatja e PLSPAK në formate të duhura për të gjitha kategoritë e PAK, duke përfshirë formate audio, Braille dhe gjuhë e thjeshtësuar.
2. Angazhimi i dy ekspertëve të jashtëm për të hartuar dhe përshtatur dokumentin e planit në formate e nevojshme.
3. Sigurimi i mjeteve didaktike dhe teknike për përshtatjen e dokumentit.

Aktiviteti 2

Prezantimi i Planit Social të PAK tek Aktorët e Ndryshëm.

1. Organizimi i një aktiviteti prezantues për PLSPAK me pjesëmarrjen e institucioneve, organizatave dhe personave me aftësi të kufizuara.
2. Publikimi i PLSPAK në faqen e internetit të Bashkisë Vlorë dhe shpërndarja e tij në formë zyrtare dhe elektronike tek aktorët relevantë.

Aktiviteti 3

Zbërthimi i Planit në Aktivitete më të Detajuara

1. Zbërthimi i PLSPAK në aktivitete të detajuara ndëryesore, gjashtëmujore dhe tremujore për të siguruar zbatimin e saktë dhe të planifikuar të tij.
2. Formimi i një grupi pune me përfqësues nga sektorë të ndryshëm për ndjekjen e zbatimit të planit dhe marrjen e masave të nevojshme.

Aktiviteti 4

Monitorimi periodik i planit të veprimt.

1. Realizimi i analizës vjetore të zbatueshmërisë së planit dhe diskutimi i rezultateve me aktorët relevantë.
2. Raporti i vlerësimit periodik prezantohet në Këshillin Bashkiak dhe u dërgohet institucioneve dhe organizatave përkatëse për feedback dhe rishikim të mundshëm.

